



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 24.06.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 10 dhe 11 qershor 2019.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i draftkalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 1-19 korrik 2019.
3. Vazhdimi i procedurës së shqyrtimit të kërkesës së disa deputetëve për fillimin e procedurës së shkarkimit të Presidentit të Republikës.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Edmond Leka, Bashkim Fino, Elena Xhina, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Aurora Mara, Alban Zeneli, Adriatik Alimadhi dhe Ralf Gjoni.

Mungojnë:

Damian Gjikhuri, Andi Përmeti, Ediola Braha, Fatmir Xhafaj, Elda Hoti dhe Tom Doshi.

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Kuorumi është i pranishëm për të vazhduar me rendin e ditës.

Si fillim kemi miratimin e procesverbaleve të datave 10 dhe 11 qershor 2019.

Procesverbalet e zbardhura ju kanë ardhur nëpërmjet postës elektronike. A ka sugjerime, komente apo vërejtje për to? Nuk ka.

Miratohen.

Pika e dytë është shqyrtimi dhe miratimi i draftkalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 1-19 korrik 2019. Draftkalendarin e keni mbi tavolinë. Ka sugjerime për të?

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, kryetar!

Ju e dini që Komisioni i Ligjeve ka filluar procedurën për shqyrtimin e projektligjit për nismën legislative të zgjedhësve, për të cilën patëm edhe një kërkesë nga Kryetari i Kuvendit për të marrë një opinion të Komisionit të Venecias.

Komisioni i Venecias e ka dhënë opinionin në fund të vitit të kaluar, madje në një periudhë shumë të shkurtër. Ndërkohë, do të sugjeroja që ky projektligj të përfshihet në kalendar dhe të miratohet brenda këtij sesiioni plenar.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Jeni dakord që projektligjin për nismën ligjvënëse ta përfshijmë në kalendar për datat 1-19 korrik?

Ka sugjerime të tjera për kalendarin? Nuk ka. Kush është dakord që në kalendarin e punës së komisionit për periudhën 1-19 korrik 2019, që i referohet saktësisht kalendarit të miratuar në seancën plenare të Kuvendit, të shtohet edhe nisma ligjvënëse e shtetasve? Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës, të cilën e kemi miratuar me kalendarin e posaçëm për shqyrtimin e kërkesës së 55 deputetëve për fillimin e procedurës së shkarkimit të Presidentit të Republikës.

Në seancën paraardhëse, në lidhje me këtë pikë të rëndësishme të rendit të ditës, u bë prezantimi i kërkesës nga nismëtarët, po ashtu pati edhe një seancë pyetje-përgjigje me nismëtarët dhe deputetët e Komisionit të Ligjeve, si dhe u caktuan dy relatorë për shqyrtimin e kësaj kërkesë, kolegja Bushka dhe kolegu Shameti.

Sot, sipas kalendarit, është vazhdimi i procedurës së shqyrtimit të kërkesës së deputetëve për fillimin e procedurës së shkarkimit të Presidentit të Republikës dhe e kemi programuar si seancë diskutimi. Para se të hapim diskutimin në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës, dua t'u bëj me dije kolegëve të mi deputetë, por edhe opinionit publik, se në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Ligjeve, siç edhe u vendos në mbledhjen paraardhëse, në zbatim të nenit 112, pika 2, të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, i kam dërguar Presidentit një ftesë nëse ai dëshiron të paraqitet në një seancë dëgjimore në Komisionin e Ligjeve, nëse ka diçka për të shtuar tej arsytimit që ai ka bashkëshoqëruar dekretin për anulimin e datës së zgjedhjeve.

Natyrisht, ky njoftim është bërë në respektim të plotë të nenit 112 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë për t'i garantuar Presidentit aksesin për t'u dëgjuar para Komisionit të Ligjeve. Paraqitja ose jo e Presidentit pranë komisionit është në diskrecion të lirë të tij.

Presidenti me shkresën nr.2502/4 protokolli, datë 22.06. 2019, i ka kthyer përgjigje komisionit tonë që arsyet e dekretit për anulimin e zgjedhjeve të datës 30 qershor 2019 i ka dhënë me shkrim dhe nuk e çmon të nevojshme të paraqitet pranë komisionit.

Kjo nuk e pengon aspak Komisionin e Ligjeve për të vazhduar me kërkesën e 55 kolegëve për shkarkimin e Presidentit të Republikës, bazuar në nenin 90/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Përgjigjen zyrtare të Presidentit të Republikës ua kam vënë në dispozicion të gjithë kolegëve deputetë dhe, natyrisht, edhe me arsyet që janë bërë të ditura në njoftimin e Presidentit, ditën që ai nxori dekretin nr. 11199, datë 10.06.2019 "Për shfuqizimin e dekretit 10928, datë 05.11.2019 për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore në datën 30 qershor 2019".

Pas këtij sqarimi, e konsideroj të hapur debatin për kërkesën e kolegëve deputetë për shkarkimin e Presidentit të Republikës.

Jeni njohur me kërkesën dhe argumentet kushtetuese juridike të deputetëve që kanë nënshkruar, 1/4 e deputetëve sipas Rregullores, natyrisht ka pasur edhe seancë pyetje-përgjigje, sot jemi në seancë diskutimi. Kush e do fjalën?

Kjo do të thotë që jeni të gjithë dakord me argumentet e dhëna në kërkesën e nismëtarëve?
Po, zoti Gjoni.

Ralf Gjoni – Sipas Kushtetutës, Presidenti i Republikës shkarkohet vetëm nëse kryen një shkelje të rëndë të saj, ose një krim të rëndë. Kush e përcakton në Kushtetutë, ose cili ligj përcakton se çfarë përbën shkelje të rëndë të Kushtetutës? Mund të ma shpjegoni, se “juristët”, e kanë ndritur! Për shkak të tyre jemi në këtë derexhe të Republikës. A ka ndonjë jurist që mund të na e shpjegojë se çfarë përbën shkelje të rëndë të Kushtetutës?

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Gjoni!

Kjo çështje u ezaurua në mbledhjen paraardhëse kur u prezantua kërkesa. Pra, firmëtarët e kërkesës për shkarkim, 55 kolegët deputetë i kanë dhënë të gjitha arsyet dhe argumentet se pse Presidenti i Republikës ka shkelur Kushtetutën, sipas nenit 90/2 me nxjerrjen e dekretit për zhdekretimin e datës së zgjedhjeve 30 qershor 2019. Sot, jemi në një seancë diskutimi dhe ju mund të jepni arsyet tuaja nëse jeni pro kërkesës apo jeni në anën e dekretit të Presidentit, por këtë përgjigje e morëm në mbledhjen paraardhëse.

Po, zoti Gjoni.

Ralf Gjoni – Për t’jua sqaruar, sepse pyetja ishte pak a shumë retorike në një farë mënyre, unë nuk jam pro dekretit të Presidentit, pasi besoj që dekreti i Presidentit për të shfuqizuar dekretin e parë për caktimin e datës së zgjedhjeve është i pabazuar në Kushtetutë. Ky është mendimi im personal.

Unë besoj tek institucionet dhe besoj se institucioni primar, i cili mund ta shqyrtojë këtë ligjshmëri të dekretit apo të zhdekretimit të Presidentit është Gjykata Kushtetuese, pavarësisht se mund ta trajtojë edhe si akt administrativ. Sipas meje, hapi për ta shkarkuar Presidentit është i nxituar, sepse nuk besoj se ka pasur karshillëk zyrtar, por ka pasur shprehje të mendimit nga ana e Presidentit të Republikës nëpër media për legjitimitetin e parlamentit, por ende nuk kemi të bëjmë me një akt të Presidentit për të zhvlerësuar apo për të delegjitimuar autoritetin dhe ligjshmërinë e këtij parlamenti. Nëse do të ishim përballë një rasti të zhvlerësimit të ligjshmërisë të autoritetit të

parlamentit dhe të mosnjohjes së parlamentit, atëherë do të ishim në një tjetër lojë dhe patjetër që do të kishte argumente për shkarkimin e Presidentit.

Arsyeja pse po e them këtë, që të mos keqinterpretohet nga kolegët e tjerë, por edhe nga publiku i gjerë përmes medieve, është se unë nuk po mbaj anën e Ilir Metës, por mua më duket që kjo politikë shkarkimi është një lojë politike që ju po bëni dhe është e pabazuar në Kushtetutë dhe më duket e pakuptimtë për sa kohë që mungon Gjykata Kushtetuese. Pra, është një lojë që po hapet për të bërë zhurmë medietike.

Dakord, nëse ka argumente reale që Presidenti ka kryer shkelje të rëndë të Kushtetutës apo ka kryer një krim të rëndë, patjetër që parlamenti duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme dhe unë do të isha i pari që do të votoja shkarkimin e Presidentit. Por në argumentin që na është paraqitur neve si anëtarë të komisionit nuk shoh bazë të mjaftueshme ligjore për të justifikuar shkelje të rëndë të Kushtetutës. Ky është mendimi im.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Gjoni!

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, të dashur kolegë!

Ne sot jemi në një seancë diskutimi për zhdukjet që Presidenti u ka bërë zgjedhjeve. Personalisht, dua t'ju kujtoj se ne jemi një komision që po shohim procedurën e 55 kolegëve tanë, pra a është kjo procedurë e rregullt? A janë firmat në rregull? A janë ligjore dhe korrekte të gjitha argumentet që dha kryetari dhe sekretari i grupit parlamentar? Më pas, pas diskutimit që bëhet në komision, ne i paraqesim një raport Kuvendit dhe Kuvendi do të ngrejë një komision hetimor për të vërtetuar të gjitha këto që tha parafolësi.

Më lejoni që në diskutimin tim t'ju përmend tre momente kryesore. Ajo që bën përshtypje, zoti kryetar, besoj se zoti Gjoni nuk e ka lexuar, është letra që Presidenti i ka dërguar Kuvendit të Shqipërisë nëpërmjet...

(Diskutime pa mikrofon)

E ke lexuar, po mirë dëgjo atëherë!

... sekretares së Përgjithshme, si dhe argumentet e zhdukjet. Gjuha e përdorur nga Presidenti në letrën e tij është ironike, hipokrizi dhe paragjykim. Pse i them këto tre elemente? I them këto, sepse po të lexoni, do të mundohem t'ju marr pak kohë për t'ju lexuar të tre paragrafët,

në letrën e tij Presidenti thotë: “Veprimtaria aktuale parlamentare që përpiqet të godasë veprimtarinë e Presidentit të Republikës, por pa mundur të rrëzojë përmbajtjen e dekretit të tij, është një proces i rremë, i pambështetur në argumente kushtetuese, por vetëm i rënduar verbërisht politik”. Vetëm kjo ironi nuk shkon, sepse po të ishte për të drejtuar në mënyrë të verbër politikisht, mund të kishim marrë masa apo hapa që më parë, por ne jemi para një shkelje të nenit 92 të Kushtetutës dhe për shkak të kësaj me dhimbje kemi ndërmarrë këtë masë që po ia paraqesim Kuvendit.

Çështja e dytë që shtron Presidenti në letrën e tij: “Ky proces i rremë dhe verbërisht politik nuk i shërben aspak krizës së thellë në të cilën ndodhet vendi, por përkundrazi e rëndon më tepër atë si një përpjekje e shfrenuar për të thelluar ndasinë midis palëve dhe për të asgjësuar çdo mundësi për krijimin e klimës së dialogut dhe të bashkëpunimit që Presidenti i Republikës e ka kërkuar prej kohësh”. Kur e ka kërkuar prej kohësh? E kërkoi pardje kur bëri një deklaratë dhe tha: “Jam gati të ulem, të bashkëbisedojë e të tjera me radhë...”. Pse nuk e kërkoi që në fillimet e kësaj krize, nëse ai e quan të tillë? Ja, edhe këtu hipokrizia e radhës.

A doni edhe të fundit fare, e cila madje na fyente, sepse ky është një paragjykim fytes, unë të paktën e marr fyerje personale, nuk e di nëse Ralfi e merr të tillë. Në fund Presidenti thotë: “Për shfuqizimin e dekretit nr. 10928, datë 05.11.2018 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të organeve të qeverisjes vendore më datën 30 qershor 2019, për këtë arsye për një gjykim të shëndoshë (nëse kjo do t’ju lejohet për ta lexuar)...”. Çfarë është ky paragjykim dhe kjo fyerje që u bëhet deputetëve?

Gjithsesi, nuk po merrem më me letrën e tij, por po futem në argumente, zoti kryetar. Pse 55 kolegët tanë dhe Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste kanë kërkuar që të rrëzohet Presidenti i Republikës? Dekreti i datës 10 qershor është absolutisht i pavlefshëm, sepse ai është një akt që nuk mund të nxirret dhe nëse nxirren nuk mund të zbatohet. Pse e them këtë? Që akti administrativ të jetë absolutisht i pavlefshëm duhet të verifikohen disa rrethana konkurruese me njëra-tjetrën dhe se cila prej tyre e bën aktin absolutisht të pavlefshëm. Në rastin e dekretit të datës 10 qershor është verifikuar më shumë se një prej tyre. Dekreti, siç e thashë edhe më lart, vjen në kundërshtim të hapur, flagrant me nenin 92 të Kushtetutës, germa “gj”, si për kompetencën, ashtu edhe për procedurën, shkelja e kësaj shkronje të nenit është bërë dyfish, për mendimin tim është haptazi antikushtetuese:

a) Kompetenca për caktimin e datës së zgjedhjeve. Në raport me zgjedhjet Presidentit të Republikës ka vetëm një kompetencë, ka kompetencë vetëm atë të caktimit të datës së zgjedhjeve. Caktimi i datës së zgjedhjeve është kompetencë e Presidentit, por jo privilegj i tij, por ai kështu e ka kuptuar. E thënë ndryshe, është detyrim dhe jo e drejtë.

Kjo kompetencë nuk deinstitutionalizohet, por nuk varet as nga vullneti i tij, është e lidhur me kushtet rigoroze ligjore dhe për nga natyra e saj hyn në grupin e kompetencave formale të Presidentit. Pra, bën përlllogaritjen e datës dhe është një kompetencë formale.

Kriteret që vendosen për datën e zgjedhjeve nuk mund të jenë kritere që bazohen në interesa politike, nuk ndikohen nga interesat e konkurruesve, por janë kritere që lidhen me interesin më të mirë të zgjedhësve shqiptarë.

Së dyti, mungesa e kompetencës për zhdekretim.

Neni 92, shkronja “gj” e Kushtetutës i njeh Presidentit të Republikës kompetencën për dekretimin e datës së zgjedhjeve, por kjo nuk përkthehet dot në kompetencë për zhdekretim. Pse? Sepse dekretimi i datës së zgjedhjeve është një akt me efekte të njëhershme, ngjarja ndodh dhe kryhet, apo jo, ngjarja nuk zgjat, ngjarja nuk vazhdon, ngjarja nuk është proces. Dekretimi nuk është hapi i parë i vendimmarrjes së Presidentit, por është hapi i parë dhe i fundit i tij. Ky është dekreti, për mendimin tim.

Neni 92, shkronja “gj” e Kushtetutës nuk mund të shërbejë si një kompetencë për zhdekretimin e zgjedhjeve, sepse për zgjedhjet vendore të 30 qershorit kjo kompetencë është ushtruar një herë, kur ai e ka ndër marrë këtë që në nëntor të vitit të kaluar.

E gjithë veprimtaria dhe hapat që janë marrë, e gjithë kjo kosto që ka lidhje procedurale me dekretin dhe caktimin e datës së zgjedhjeve nuk mund të zhbëhet me një zhdekretim. E thënë me fjalë të tjera, zotërinj deputetë, Presidenti ka marrë një copë letër, ka shkruar aty çfarë ka dashur, i ka vënë titullin “Dekret” dhe do të na e shesë si të tillë. Nuk është titulli ai që përcakton llojin e aktit, por është referenca kushtetuese ose ligjore dhe mbështetja në dispozita të normave juridike ajo që përcakton se me çfarë lloj akti kemi të bëjmë. Me këtë logjikë Presidenti mund t’i kishte vënë edhe titullin vendim i Këshillit të Ministrave letrës së vet, por ky titull nuk e bën atë VKM, apo jo?

Pasojat antikushtetuese të konsiderimit të letrës si dekret me vlerë juridike nëpërmjet përdorimit të termit “dekret”, presidenti Meta synon anulimin e zhvillimit të zgjedhjeve.

Konsiderimi i kësaj letre, si dekret i vlefshëm, do të kishte pasoja, së pari, në cenimin e së drejtës së individit për të zgjedhur, dhe për t'u zgjedhur, madje është e rëndë që këtë përpiket ta argumentojë sikur po vepron në kushtet e mbrojtjes së këtyre të drejtave të zgjedhësve; së dyti, në nxjerrjen jashtë afatit kushtetues të mandatit të organeve të zgjedhura të qeverisjes vendore, domethënë shkel nenin 109 të Kushtetutës ku organet e qeverisjes vendore në largim nuk mund të ushtrojnë tagra pushteti pas përfundimit të mandatit të tyre si organe të zgjedhura; së treti, në zhbërjen pa shkak ligjor, dhe kjo është më e rënda, të këtij procesi zgjedhor, i cili është konsumuar mbi 95%, sepse e bëri në mes të fushatës së këtyre zgjedhjeve.

Të gjitha këto arsye për mua përbëjnë elemente shumë të rënda të shkeljes së Kushtetutës nga Presidenti i Republikës për zhdekretimin e datës së zgjedhjeve.

Faleminderit!

Ulsi Manja- Faleminderit!

Zoti Braho.

Spartak Braho – Më vjen shumë mirë që një koleg i yni, zoti Fino, që, ndonëse është ekonomist në profesion, paraqiti me kompetencë të lartë arsyet pse dekreti i Presidentit është i papabuar në ligj dhe në Kushtetutë. Ndërkohë vërej se kolegë të tjerë nuk e kanë kuptuar ende pse kanë ardhur sot këtu.

I dashur Ralf, dekreti i Presidentit nuk është llastik për të mbathura që mund të hapet sa herë dhe sa të duash, por është shtyllë. Neni 92, pika 2 thotë: “Presidenti i Republikës dekreton zgjedhjet”. Neni nuk i ka fjalët: “njoftim”, “zhdekretim”, “zhvendim”, pasi veprimi i Presidentit ose ai që quhet zhdekretim, nuk parashikohet fare në Kushtetutë.

Natyrisht ju jeni i bindur për këtë punë, por mos u merrni me juristët, nuk vjen e keqja nga juristët, madje e keqja vjen nga ata që nuk dëgjojnë juristët.

Së dyti, unë do të thosha që ne sot nuk jemi mbledhur për të shkarkuar Presidentin, kuptojë edhe këtë. Ne sot jemi mbledhur për të filluar një procedurë, e cila do të konkretizohet me ngritjen e një grupi hetimor ose komisioni hetimor, i cili do të konstatojë nëse është shkelje e rëndë apo nuk është shkelje e rëndë, pas kësaj do të vendoset. A e kupton këtë që po them unë? Kështu që le t'i japim mundësi parlamentit, të fillojë një procedurë, ta hetojë situatën. Uroj që Presidenti të mos e ketë shkelur rëndë, që të shkarkohet, por për mendimin tim shkelja është e rëndë, megjithatë të ngrihet një komision hetimor. Unë do të kërkoj që ti të jesh anëtar i atij komisioni dhe ta shikosh me sytë e tu që presidenti e ka shkelur rëndë Kushtetutën.

Si përfundim, unë bashkohem me konkluzionin që paraqiti zoti Fino dhe zotërinjtë relatorë, ne t'i hapim rrugë komisionit hetimor.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Braho!

Mund të marrësh fjalën dhe të shpjegohesh me të gjitha.

Për procedurë, zoti Alimadhi.

Adriatik Alimadhi – Vetëm për procedurë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja– Zoti Gjoni, ju lutem, jeni pa mikrofon.

Zoti Gjoni, nuk është argument të flasësh pa mikrofon.

Zoti, Gjoni jeni pa mikrofon.

Nuk është fjalë fyese, se i fyeve të gjithë kolegët kur more fjalën në fillim dhe the ky nuk është panel juristësh.

Adriatik Alimadhi- Zoti kryetar, në mbledhjen mëparshme ne caktuam dy relatorët dhe do të ishte mirë për procedurë që të dëgjonim relatorët mbase kjo e kompletton më mirë procesin ose mbledhjen e sotme të komisionit.

Ulsi Manja - Zoti Alimadhi, relatorët i kemi prezent dhe kanë të drejtën të flasin, por unë kam gjykuar që relatorët duhet të dëgjojnë të gjithë diskutimin e kolegëve, sepse do të përgatisin një relacion për komisionin, të cilin ne do ta votojmë. Prezantimi i kërkesës u bë nga nismëtarët, ndërsa relatorët nuk kanë pse ta gjykoj debatin që në fillim, sepse duhet të jetë diskutimi i hapur.

Nëse relatorët do të shfaqin mendimin e tyre që në fillim i bie që ta ngushtojmë nivelin e diskutimit dhe debatit në komision.

Po, zoti Lita.

Korab Lita – Faleminderit!

Unë mendoj se e gjithë kjo situatë e krijuar dhe momenti i paligjshmërisë që po thellohet ngjan me situatën...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja- Ju lutem, zoti Braho dhe zoti Gjoni mund të dilni të sqaroheni jashtë, pa mikrofon.

Korab Lita- Kjo situatë i ngjan asaj ku hajduti thotë kapni hajdutin.

Aktorët kryesorë të gjendjes së krijuar në Shqipëri, të cilët janë presidenti dhe qeveria për shembjen dhe mungesën e institucioneve në Shqipëri thonë tani paskemi hyrë në një rrugë pa krye,

sepse nuk paska institucione. Situatën e krijuar po prej tyre ia paraqesin qytetarëve si krizë institucionale. Kujt ia kërkojnë zgjidhjen e kësaj situatë? Paligjshmëria shkon deri aty sa, edhe nëse ka mbetur ndonjë institucion kushtetues në Shqipëri, Presidenti, institucioni më i lartë i shtetit nuk njeh institucionet kushtetuese ose parlamentin dhe madje del dhe me karshillëk thotë se nuk e njeh këtë parlament, madje shkon më tej dhe thotë që nuk është zgjedhur nga ky parlament, por është zgjedhur nga ai parlament legjitim.

Por për cilin parlament e ka fjalën Presidenti që është? Për atë parlamentin ku gjysma e anëtarëve të tij sot janë para drejtësisë? Të paktën ky parlament nuk ka të tillë. Nëse Presidenti ndjehet krenar se është zgjedhur nga ai parlament, kjo mbetet në gjykimin e tij. Presidenti, duke menduar se meqë u shembën të gjitha institucionet dhe nuk ka kontroll mbi këtë shtet, merr iniciativën të bëjë copash Kushtetutën, të nxjerrë dekretin që nuk ishte parë ndonjëherë në histori, të shtyjë datën e zgjedhjeve, por pa dhënë një datë tjetër zgjedhjesh. Unë mendoj se duhet të ishte caktuar data e zgjedhjeve në të njëjtin zhdekret, me qëllim që të mos prishej serioziteti i zgjedhjeve në Shqipëri. Sot jemi jashtë të gjitha afateve kushtetuese për zgjedhjet në Shqipëri. Kjo sipas logjikës së Presidentit. Kështu që unë mendoj që vetë Presidenti, duke gjetur terrenin e paligjshmërisë së krijuar prej tij, i cili, në mungesë të institucioneve, vazhdon duke thëlluar më shumë paligjshmërinë e tij. Unë mendoj se kjo situatë duhet të marrë fund në Shqipëri.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Lita!

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë jam njohur më të gjitha argumentet e bëra nga firmëtarët, njëkohësisht, edhe me dy shkresat që ju na keni vënë në dispozicion. Po analizoj aspektin formal të përgjigjes që ka sjellë sekretarja e Përgjithshme e institucionit të Presidentit të Republikës dhe argumentet e firmosura më pas në shkresën e tij të titulluar “Arsyet e Presidentit të Republikës” .

Të nderuar kolegë, ne jemi republikë parlamentare dhe komunikimi i bërë ndërmjet kryetarit të komisionit, zotit Manja, me sekretaren e Përgjithshme të institucionit të Presidentit të Republikës duhej të ishte institucional, duke respektuar Kushtetutën dhe gjuhën e komunikimit. Më lejoni t’ju kujtoj përgjigjen e shkresës së ardhur më datën 22 qershor të vitit 2019 me nr.protokolli 1956/1, e firmosur nga sekretarja e Përgjithshme, zonja Ornela Zonja.

Besoj se në një republikë parlamentare secili institucion respekton kompetencat, aq më tepër një punonjës i shërbimit të administratës së Presidentit. Është shkelje flagrante e etikës së komunikimit ndaj një deputeti, që është kryetari i komisionit, i cili përfaqëson Komisionin e Ligjeve dhe të gjithë ne, kur zonja Ornela Zonja jep argumente politike dhe futet në një debat politik me kryetarin e Komisionit të Ligjeve, çka do të thotë automatikisht edhe me ne. Unë nuk besoj se kjo gjuhë është e zonjës Ornela Zonja, por, meqenëse shkresa është e nënshkruar prej saj, kam të drejtë ta evidentoj këtë gjë. Nuk mundet që një sekretare e Përgjithshme të thotë se procesi zgjedhor është fiktiv, është pa garë dhe pa alternativë. Nuk është sekretarja e Përgjithshme ajo që vlerëson proceset në Shqipëri.

Së dyti, nuk është në të drejtën e sekretares së Përgjithshme të institucionit të Presidentit të thotë se është një proces i rremë dhe i pambështetur në argumente.

Së treti, nuk është e vërtetë kur ajo thotë se prej kohësh u është kërkuar palëve që të dialogojnë.

Të nderuar kolegë, unë do të doja të riktheja në vëmendjen tuaj argumentet që kanë parashtruar kolegët firmëtarë.

Konkretisht te paragrafi 33 i materialit është thënë qartë: “Presidenti i Republikës shpall datën e zgjedhjeve jo më vonë se 9 muaj para mbarimit të mandatit të Kuvendit”. Në këtë kuadër, për t’i dhënë edhe një përgjigje zonjës Ornela Zonja, Presidenti i Republikës i ka pasur të gjithë kohën dhe mundësitë, nëse do të kishte dëshirë, për të ndërmjetësuar dhe për të dialoguar, gjë të cilën nuk e ka bërë. Në këtë kuadër, për ta mbyllur këtë lloj shkrese, i nderuar zoti Kryetar, do të kërkoja që ju të jepnit një përgjigje zyrtare për shkeljen e etikës dhe për uzurpimin e kompetencave të disa institucioneve, të cilat vlerësojnë nëse procesi i datës 30 qershor është demokratik, me standarde apo pa standarde.

Po kthehem tek arsyetimet e sjella nga Presidenti i Republikës me anë të të cilave ai përpiqet të sqarojë pse e ka shfuqizuar dekretin nr. 10928.

Unë nuk do të doja të përsërisja atë që, me të drejtë tha kolegu Fino lidhur me mungesën e bazës ligjore. Në 8 argumentet e sjella, gjuha e përdorur në shkresë është një gjuhë jojuridike, jokushtetuese, por një gjuhë politike, si dhe tregon se ai nen i Kushtetutës, ku theksohet se Presidenti i Republikës është përfaqësues i unitetit të popullit nuk funksionon dhe nuk pasqyrohet në këtë shkresë. Pra, të 8-ta argumentet që sillen, janë argumente politike. Në shumicën prej tyre, me përjashtim të nenit 92 të Kushtetutës, nuk përmenden dispozita të tjera që të justifikojnë

zhdekretimin e datës së zgjedhjeve. Ajo që do të doja të theksoja është se nëse kolegët firmëtarë kanë sjellë argumente ligjore dhe Kushtetuese, kundërgargumentet, që sjell Presidenti i Republikës si arsytim, janë argumente politike, madje mbajnë anën e opozitës. Më lejoni të citoj, pa dashur të përsëris ato që tha kolegu Fino, gjuhën që është përdorur në dokumentin që na ka vënë në dispozicion Presidenti i Republikës.

Presidenti i Republikës thotë se nuk është e vërtetë që opozita nuk do të marrë pjesë në zgjedhje, sepse ajo do, por me kushtin që të garantohet e drejta e qytetarëve për të votuar të lirë dhe të konkurrohet lirisht nga të gjitha forcat politike. Lidhur me këtë argument, unë dua të bëj disa pyetje.

Nenet 45 dhe 46 të Kushtetutës përcaktojnë qartë të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, si dhe zgjedhjet duhet të jenë të lira dhe demokratike. Te ne nuk funksionon sistemi që kanë disa vende, ku pjesëmarrja në zgjedhje është e detyrueshme. Pra, çdo qytetar ka të drejtë të vijë ose jo në qendrën e votimit. Gjithashtu, çdo subjekt zgjedhor ka të drejtë të marrë pjesë në zgjedhje ose jo. Pra, me kodin që ne kemi në fuqi, kjo është një e drejtë dhe nuk është detyrim. Unë nuk arrij të kuptoj se si mund të thuhet se opozita do që të marrë pjesë në zgjedhje, kur vetë liderët e opozitës thonë se nuk duan të marrin pjesë në zgjedhje. Nga ana tjetër, afatet e regjistrimit të opozitës kanë qenë të parashikuara në Kushtetutë, në ligj dhe opozita këtë e di shumë mirë. Pra, në faqen 6, arsytimi i Presidentit, ku thuhet se partitë politike nuk kanë shprehur vullnetin për mospjesëmarrje në zgjedhje, është një gënjeshtër e madhe, sepse ata e kanë shprehur vullnetin për të mos marrë pjesë në zgjedhje, madje e kanë ditur shumë mirë dhe kanë reaguar për të mos marrë pjesë me veprime konkrete.

Unë kam tri pyetje: si mund të sillet si arsytim se zgjedhjet i shtynë për arsye se opozita kërkon që të marrë pjesë në zgjedhje, në një kohë kur opozita i bojkotoi parlamentin dhe Komisionin e Reformës Zgjedhore pikërisht ditën kur ekspertët gjermanë të OSBE-ODIHRI-it na vunë në dispozicion, si anëtarë të komisionit të reformës zgjedhore draftin e dakordësuar shumicë-pakicë. Pikërisht në atë moment kur ne duhet ta diskutonim dhe ta kalonim në seancë plenare, opozita u largua.

Së dyti, ku e shikon Presidenti këtë dëshirë të madhe të opozitës për të marrë pjesë në zgjedhje, kur opozita ka bërë protesta dhe vazhdimisht thotë se nuk ka zgjedhje?! Në këtë kuadër, në argumentin e dytë që sjell Presidenti, në faqet 6 dhe 7 nuk ka argumente kushtetuese.

Në argumentin e tretë Presidenti thotë: “Zhvillimi i zgjedhjeve në kushtet e një shtate të tensionuar politike mund të sjellë mospjesëmarrje në zgjedhje të rreth gjysmës së votuesve, duke krijuar kështu rrezikun e një konflikti civil”. Unë mund të kuptoj se liderët e opozitës mund të shprehen për dhunë, për mosbindje civile dhe janë shprehur në të gjitha takimet, në të gjitha protestat, tubimet dhe antimitingjet që kanë bërë, por ta shikoj në një shkresë të drejtuar nga Presidenti i Republikës, i cili duhet të përfaqësojë unitetin e popullit, sinqerisht më vjen shumë keq!

Angazhimi në mënyrë racionale dhe efektive për të mbrojtur vlerat dhe parimet kushtetuese nuk bëhet 10 ditë para zgjedhjeve, por duhet bërë pikërisht atëherë, kur opozita e ka bojkotuar parlamentin. Mos harroni se opozita ka qenë në bojkot për një periudhë të gjatë, pas zgjedhjeve të vitit 2017, dhe ka pasur të gjitha mjetet dhe mundësitë ligjore kushtetuese për t’i ulur partitë dhe për të mos lejuar këtë lloj bojkoti të parlamentit në momente shumë të rëndësishme, e ritheksoj pa u lodhur të miratimit të institucioneve më të rëndësishme të reformës në drejtësi.

Të nderuar kolegë, mos harroni se opozita që është në rrugë ka bojkotuar gjashtë momentet më të rëndësishme të reformës në drejtësi. Nuk është rastësi, sepse janë data ligjore kushtetuese dhe veprime konkrete të përcaktuara dhe të regjistruara në procesverbalet e këtij komisioni. Në këtë kuadër edhe ky argument nuk qëndron dhe nuk plotëson atë argument që sjellin kolegët firmëtarë, sepse shtyrja e datës së zgjedhjeve nuk ka ofruar dialog, alternativë dhe zgjidhje, madje ju e patë se çfarë ndodhi në disa nga KZAZ-të e bashkive që qeverisen nga opozita. Pra, kjo është pasqyrimi i fushatës së shkatërrimit, mitingjeve dhe antimitingjeve që ka bërë opozita.

Të nderuar kolegë, në faqen 8 thuhet: “Presidenti i Republikës ka ndjekur të gjitha protestat e zhvilluara nga forcat opozitare dhe provokimet e bëra nga maxhoranca”.

Të nderuar juristë dhe jojuristë në komision, ne jemi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, kush ka bërë protesta të dhunshme dhe antimitingje, maxhoranca apo opozita?

Është interesante edhe në paragrafët 2 dhe 3 në faqen 8 thuhet: “Presidenti ka ndjekur të gjitha protestat e zhvilluara nga forcat opozitare dhe kundërpërgjigjet me antimitingje të maxhorancës”. Më fal, por në një dokument arsyetimi që i përgjigjet Komisionit të Ligjeve unë mendoj se Presidenti duhet të qëndrojë larg analizës së mitingjeve të shumicës dhe antimitingjeve të pakicës, pra ai duhet të japë argumente kushtetuese që rrëzojnë, nëse është në gjendje, të gjitha argumentet që kanë sjellë në arsyetimin e tyre firmëtarët. Si mund të thuhet thirrje kërcënuese të

maxhorancës? Cilat janë thirrjet kërcënuese të maxhorancës? Kush ka bërë thirrje për djegie, për konflikt dhe për mosbindje civile? Kush ka kërcënuar policinë? Kush ka bllokuar Kryeministrin dhe qytetarët e tjerë? Në këtë kuadër vlerësoj se Presidenti edhe në arsyetimin që sjell i ka kapërcyer kompetencat e tij për të qenë neutral dhe mbi palët.

Përveç marrjes së kompetencave për vlerësimin e kësaj situatë politike, lexoni paragrafin 4, ku merr kompetencat e prokurorisë dhe thotë: “Përdorimi i mjeteve teknike nga Policia e Shtetit është reagim jo proporcional”. Ju e dini që për të gjitha protestat e dhunshme të zhvilluara nga opozita në rrugë ka vendngjarje, ka procedime penale, ka persona që janë nën hetim, por ka edhe një organ të prokurorisë, të cilin ne e kemi organizuar dhe funksionon në bazë të ligjit i pavarur dhe i shkëputur nga politika. Pra, është ky organ që duhet të thotë nëse veprimet e Policisë së Shtetit nëpër mitingje dhe antimitingje, që ka bërë opozita, janë reagime propocionale apo jopropocionale dhe nuk është Presidenti i Republikës, ai nuk mund të marrë kompetencat e prokurorit të çështjes apo të prokurorëve, meqenëse ka disa çështje.

Të nderuar kolegë, në kërkesën që paraqesin kolegët firmëtarë është pranuar se ka disa raste të shtyrjes së zgjedhjeve, ku përmenden dy raste, si në zgjedhjet e vitit 2007. Mua më vjen keq se në arsyetimin që sjell Presidenti i Republikës nuk përmend një fakt, që në rastin kur janë shtyrë zgjedhjet e vitit 2007 ishte parlamenti ai që ka bërë ndryshimin në Kodin Zgjedhor, ku ka parashikuar një dispozitë kalimtare për ndryshimin e datës së zgjedhjeve. Përse e them këtë? Në rast se kolegët firmëtarë të kërkesës për nisjen e procedurës për shkarkimin e Presidentit të Republikës parashitrojnë të gjitha argumentet ashtu siç janë, në arsyetimin që sjell Presidenti i Republikës dhe konkretisht në paragrafin e parë të faqes 11, ku përmendet shtyrja e datës së zgjedhjeve të shkurtit të vitit 2007, nuk përmend faktin që parlamenti ishte ai që bëri ndryshimin në Kodin Zgjedhor, i cili u miratua me 84 vota dhe më pas e ka dekretuar Presidenti. Në rastin konkret Presidenti ka marrë kompetencat e parlamentit.

Ne jemi republikë parlamentare, nëse partitë politike bien dakord që të shtyhen zgjedhjet, gjithmonë brenda kuadrit kushtetues, këtë nuk duhet të harrojmë, se edhe këtu është brenda kuadrit kushtetues dhe afateve kushtetuese, ndryshimi bëhet, por bëhet nga partitë politike. Pra nuk mund të kapërcehet parlamenti dhe kjo kompetencë të merret nga Presidenti i Republikës.

Në vitin 2017 shtyrja është bërë me një javë, nga 18 qershori më 25, pra jemi brenda afateve kushtetuese. Këtë e kanë bërë partitë politike dhe kjo është traditë. Pra, këto argumente nuk

përmenden, por anashkalohen në arsyetimet e sjella. Në këtë kuadër me këtë argument dhe me këtë mënyrë të trajtimit të problemit Presidenti ka marrë kompetencat e parlamentit.

E fundit, zoti kryetar, po i rikthehem përsëri shkresës që ju keni marrë nga sekretarja e përgjithshme. Të nderuar kolegë, a mund të më thoni se si mund ta lexojmë paragrafin e parafundit, si kërcënim, si shantazh apo si tërheqje vëmendje për parlamentin në një republikë parlamentare?

Zonja Ornela Zonja thotë: “Presidenti i Republikës garanton Kuvendin e Shqipërisë se është në detyrë, i gatshëm dhe me përgjegjësi të plotë për të ndërmarrë të gjitha vendimet e rëndësishme që do të diktojnë situata dhe interesi më i mirë i vendit”. Çfarë do të thotë me këtë? Çfarë mesazhi u jep 140 deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë? Kujt i shërben në këtë rast?

Unë nga ana juaj dua që, në respekt të Kushtetutës, por edhe për faktin se jemi republikë parlamentare, se jemi një institucion serioz, se jemi një komision që ndjekim dhe shqyrtojmë procedurat, me të drejtë e tha edhe zoti Fino, zonjës Ornela Zonja t’i jepet një përgjigje, por edhe t’i kërkohen sqarime.

Ky është precedent shumë denigrues, fyes jo vetëm kushtetues, por edhe një precedent i rrezikshëm që një zonjë godet parlamentin dhe jep një përgjigje të tillë. Presidentin edhe mund ta kuptoj, sepse e ka humbur unitetin e palëve dhe nuk është mbi palët, por stafin e presidentit nuk e kuptoj.

Të nderuar kolegë, në fund të fjalës sime dua të theksoj se institucionet ndërkombëtare kanë dalë publikisht, ku vlerësojnë protestat paqësore dhe në një shoqëri demokratike janë të nevojshme, të lejueshme dhe askush nuk mund t’i pengojë, por nga ana tjetër kanë kërkuar që të respektohet vullneti i zgjedhësve në datën 30 qershor. Por nuk e kuptoj se si mund të anashkalohet një gjë e tillë në argumentin e 8-të të Presidentit të Republikës ku thuhet: “Zhvillimi i zgjedhjeve në datën 30 qershor pa pjesëmarrjen e opozitës do të shënonte ngrirjen e progresit të integritetit europian”.

Të nderuar kolegë, për ne, për të gjitha partitë që garojnë dhe për të gjitha subjektet që janë në garë, e rëndësishme është standardi i zgjedhjeve. Pra, zgjedhjet të jenë me standarde, të jenë të lira, qytetarët të mos ndihen të intimiduar e të kërcënuar, të shkojnë në qendrën e votimit, të votojnë dhe vota e tyre të numërohet ashtu siç hidhet. Kjo është përgjegjësi që ka qeveria, komisionerët dhe e gjithë administrata zgjedhore.

Përgjegjësia që ka Presidenti është të qetësojë partitë opozitare, siç e qetësoi opozitën përpara parlamentit kur i tha: “Shpërndahuni, mos ushtroni dhunë!”. Pra, paska autoritet që të dëgjojë të dy liderët dhe të tjerët dhe të garantojë qytetarët që në datën 30 qershor, në orën 07:00 të ndihen të lirë dhe të votojnë. Presidenti do të jetë ai që do të garantojë, siç pushoi protestën dhe dhunën te Kuvendi çdo njeri që do të cenonte zgjedhjet.

Kolegë të nderuar, e fundit.

Më falni, se po dal jashtë kësaj!

Në vitin 2017 ne kemi miratuar ndryshime në Kodin Penal. A e dini ju se ato ndryshime janë bërë me mirëkuptimin dhe me kërkesën e opozitës që është në rrugë? Ato ndryshimet për krimet elektorale duhet t’i njohin të gjithë. Do të doja që në arsyetimet që tha Presidenti i Republikës të kishte një fjalë për të gjithë protestuesit për t’u thënë: “Të respektohet Kodi Zgjedhor, Kodi Penal”, sepse dënimet aty nuk janë as dënime me gjobë, as 3 muaj, as 6 muaj, por janë dënime me 3, 5, 7 dhe 8 vjet burgim.

E dyta, ligji për dekriminalizimin është bërë nga ajo opozitë që është në rrugë. Të nderuar kolegë, e dini ju se kushdo që është në procedim penal për krime elektorale dhe dënohet se nuk “puth” më në administratën publike! Nuk mund të punojë më as në administratën qendrore, as në atë vendore. Edhe këtë duhej ta kishte theksuar Presidenti.

E treta, të gjithë ata që duan të kandidojnë për kryetarë të këshillave bashkiake, për kryetarë bashkish, për deputetë, po të kenë ndjekje dhe procedime penale për krime elektorale i kap ligji për dekriminalizimin? Këtë javë njerëzit duhet t’i sqarojmë që të mos bëhen “mish për top” për interesa të njërit apo të tjetrit lider të opozitës që është në rrugë, sepse ua djegin karrierën e tyre përjetësisht, përveç vuajtjes së një dënimi. Prandaj në këtë kuadër, për ta përmbyllur, dua të theksoj:

E para, zoti kryetar, do të kërkoja që të bënim një shkresë në emrin tonë për sekretaren e Përgjithshme.

E dyta, besoj se të gjithë qytetarët kanë mundësi t’i lexojnë, t’i dëgjojnë edhe arsyetimet e Presidentit, edhe arsyetimet e kolegëve.

Ulsi Manja - Faleminderit, zonja Hysi!

Në fakt, lidhur me përgjigjen e Presidentit, u mora vetëm me anën formale të respektimit të nenit 112/2 i Rregullores dhe jo me përmbajtjen e asaj shkrese. Natyrisht, në fund edhe unë përveç drejtimit të mbledhjes së komisionit si çdo koleg kam edhe të drejtën e fjalës, kam edhe

unë mendimin tim, kam edhe të drejtën e votës. Në fund do të merrem edhe me përmbajtjen e përgjigjes që ka sjellë Presidenti.

E ka kërkuar fjalën për diskutim, zonja Mara.

Do t'ju lutesha kolegëve, cilido që do ta kërkojë fjalën për diskutim, të fokusohet tek objekti i kërkesës së 55 kolegëve deputetë për shkarkimin e Presidentit të Republikës.

Aurora Mara - Faleminderit, zoti kryetar!

Marr shkas nga fjala e zonjës Hysi. E komplimentoj për analizën shumë profesionale që bëri, si dhe na ndihmoni ne të tjerët që të mos zgjerohemi shumë në analizën profesionale e juridike.

Të nderuar kolegë, diskutimi për akte e veprime të figurave të rëndësishme si Presidenti, është jo i lehtë për të gjithë ne, por me përgjegjshmëri duhet të jemi shumë racionalë.

Në radhë të parë, detyra jonë është të respektojmë ligjet dhe Kushtetutën në çdo fushë, të mbrojmë të drejtat dhe liritë themelore siç është e drejta e votës, e drejta për t'u zgjedhur dhe për të zgjedhur. Jemi në një moment kur duhet t'i dëshmojmë jo vetëm njeri-tjetrit, por të gjithë botës se nuk jemi të zotët vetëm të miratojmë ligje, por edhe t'i respektojmë ato.

Disa nga arsyet e paraqitura nga Presidenti në përmbajtje kanë qëllim të mirë, por momenti i reflektimit të Presidentit ishte i gabuar. Institucione si Presidenti nuk mund të gabojnë as në kohë, sepse pasojat janë shumë të rënda, siç treguan edhe aktet që ndodhën pas reflektimit të Presidentit.

Nga ana juridike dhe kushtetuese është shumë e qartë se dekreti nuk ka vend. Arsyet u listuan shumë bukur edhe nga kolegët parafolës. Por shumë e rëndësishme është nga ana morale dhe e përgjegjësisë së këtij dekreti. Presidenti detyrën kryesore e ka të veprojë si *buon padre di famiglia*, pra, një baba i mirë i familjes. Pikërisht kjo detyrë kaq e rëndësishme për mendimin tim mungoi, ose ndoshta nuk u menaxhua mirë dhe në momentin e duhur. Pasojat ishin ato që ndodhën. Sollën akte të dhunshme. Pasojat e aktit janë të qarta. Ne sot duhet të diskutojmë edhe pasojat që sjell akti.

Ulsi Manja - Faleminderit!

Zoti Hyseni e ka kërkuar fjalën.

Alket Hyseni - Faleminderit, zoti kryetar!

Së pari, dua të sjell në vëmendjen e kolegëve aspektin procedural të kthimit të përgjigjes së Presidentit të Republikës, përgjigje që në gjykimin tim është e munguar. Kuvendi i Republikës

së Shqipërisë, Komisioni i Ligjeve i ka dërguar në shkresë Presidentit të Republikës dhe Presidenti i Republikës nuk ka kthyer përgjigje. Mos të konfundojë situatën e një shkresë administrative nga sekretari i Përgjithshëm. Në këtë rast kemi një procedurë kushtetuese, që përgjigjet vetëm Presidenti i Republikës. Nga ky fakt unë mendoj se Presidenti i Republikës është larguar nga funksioni i tij. Presidenti i Republikës është në mungesë të kryerjes së detyrës së tij kushtetuese. Nuk i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në një procedurë shkarkimi. Sa do e zonja, të jetë kjo zonja, unë mendoj se nuk e zëvendëson dot Presidentin e Republikës për t'i dhënë përgjigje Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Ajo që mund të bëjë ajo është që Departamenti i Administratës Publike të fillojë një procedurë disiplinore për një nëpunës të lartë të administratës, i cili bën komente politike dhe fyerje të deputetëve të Kuvendit. Pjesa tjetër nuk përbën procedurë.

Zoti Kryetar, kjo është shkresë, nuk duhet të administrohet si përgjigje e Presidentit të Republikës. Ju ftoj dhe ju që të korrigjoni emërtimin “përgjigje e Presidenti, sepse është “në mungesë të përgjigjes”. Duhet të evidentohet nga relatorët në raport që Presidenti i Republikës nuk i është përgjigjur Komisionit të Ligjeve. Kjo ishte sa për procedurë.

Më lejoni të them dy komente të miat, së pari në dimensionin politik, së dyti në dimensionin kushtetues- juridik. Në aspektin politik, nuk jam komod dhe nuk do të dëshiroja kurrë që të diskutojmë në Republikën e Shqipërisë një procedurë *impeachment*-i për Presidentin e Republikës, sepse sado që është procedurë tërësisht kushtetuese mendoj se nuk është komode për një shtet të arrijë në këtë pikë, por duke u gjendur në këto kushte, kur një President nuk është më Presidenti i Republikës, prandaj është ky parashikim kushtetues, na pëlqen apo jo ne, jemi të detyruar ta bëjmë këtë gjë, jo se cenohet ndonjë interes personal i secilit nga deputetët e Komisionit të Ligjeve, as i kolegëve të tjerë që kanë nënshkruar këtë gjë, por , sepse këtu po cenohet principi bazë i shtetit, po cenohet parlamentarizmi, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Cili është ky President i Republikës që të iluminoj ndonjë nga kolegët, që mund ta ketë harruar ose nuk e di nga periudha para se të ishte pjesë e Kuvendit se kush është ky President? Që në momentin që u zgjodh dhe pa marrë detyrën, një rast i paprecedent në të drejtën kushtetuese botërore Presidenti i Republikës bëri fushatë elektorale. Megjithatë ne nuk komentuar, sepse politikisht është problemi i tij, le ta marrë këtë ngarkesë. Edhe pse është *nonsens* kushtetues që një President i zgjedhur të dalë me famuj politikë (të mos harrojmë se bëri thirrje për armatosje) në momentin që zgjidhesh, ke marrë atributet e Presidentit. Ashtu siç ka precedentë për deputetët,

të cilët në momentin që zgjidhen, menjëherë duhet të marrin profilin e deputetit dhe kanë automatikisht përgjegjësi direkte që kur ua jep Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ashtu siç Presidentit ia dha parlamenti, ai parlament që në gjykimin e tij ishte legjitim. Patjetër që ishte legjitim, sepse Kushtetuta kështu e parashikonte.

Nga ana tjetër, vazhdojmë me lëvizjet politike të këtij Presidenti. Rast tjetër i paprecedent kur bashkëshortja që duhet të ishte Zonja e Parë e Presidencës, u bë lidere e forcës politike që kishte Presidenti dhe pavarësisht se Kushtetuta këtu nuk e parashikon një rast të tillë, këtu bëhet fjalë që, edhe pse politikisht, ka shkelje të Kushtetutës, nga pikëpamja juridike nuk ka, dhe ne nuk e kemi kontestuar këtë fakt, ndonëse, siç e thashë, rasti është i paprecedent. Më gjeni vetëm një rast tjetër, e këtu flas për demokracitë, nuk flas sistemet autoritare. Nuk ka.

Për të vazhduar me tërësinë e veprimeve të Presidentit të Republikës në vijimësi, të drejtën e tij për të votuar kahun e vet politik, por jo për të mbajtur qëndrime të hapura publike ndaj një kahu politik. Pse? Sepse këtë ia ndalon Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë që në fillim, kur përcakton se kush është Presidenti. Neni i parë i dispozitës për Presidentin e Republikës përcakton se ai është përfaqësues i unitetit të popullit. Po si mund të jesh përfaqësues i unitetit të popullit, kur bën komente politike?

Ka edhe plot e plot argumente të tjera politike sa i takon diskutimit politik.

Unë nuk do të zgjatem shumë, sepse mjaft nga kolegët i kanë përmendur, por jam i bindur se as opinioni publik nuk ka nevojë të dëgjojë argumente politike, se përse ky President nuk është më Presidenti i Republikës së Shqipërisë dhe nuk e përfaqëson më unitetin e popullit.

Për të kaluar te debati kushtetues e juridik, ne thamë se Kushtetuta parashikon rastet e shkeljes së rëndë të Kushtetutës apo rastet e kryerjes së një krimi të rëndë. Nëse ka skepticizëm se cilat janë shkeljet e rënda, unë ia bëj me dije, me modestinë time juridike, kujt do që mund të dëgjojë dhe kujt do që mund të mbajë shënim. Shkelje e rëndë kushtetuese është çdo gjë që cenon këtë Kushtetutë. Çdo veprim direkt e indirekt, por edhe çdo mosveprim i Presidentit të Republikës në përmbushje të detyrave të tij kushtetuese.

Pse janë të rënda? Le t'i rendisim për një moment.

A është i rëndë cenimi i parimit të parlamentarizmit, mbi të cilin fillon Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, kur Presidenti nuk njeh autoritetin e këtij parlamenti, parlament i cili ia ka dhënë mesazhin politik? Nëse unë do të isha në pozitën e Presidentit të Republikës, sot do të

kisha dhënë dorëheqjen. Njëqind vota, njëqind shuplaka një Presidenti që zgjidhet nga parlamenti, janë më se të mjaftueshme për t'i dhënë mesazhin politik e juridik, që ai duhet të mos jetë më.

Nëse do të ishte një President i zgjedhur nga populli, dakord, do të priste verdiktin e Gjykatës Kushtetuese, pas hapit të parë të parlamentit, por ky President është zgjedhur nga Kuvendi. Ky nuk e ka më mbështetjen e Kuvendit, qoftë edhe me rezolutë. Në vijim të kësaj procedure, le të shikojmë dhe le të urojmë të mos jetë e vërtetë që i ka bërë këto shkelje, por unë ju garantoj se janë, sepse nuk do ta kishim nisur këtë procedurë, në të cilën unë jam një nga firmëtarët. E kemi gjykuar mirë. Nuk jemi nxituar. Nuk jemi të verbër politikisht. Kemi pasion politik, por asnjëherë nuk e ngatërrojmë pasionin politik me detyrimin tonë kushtetues.

Kemi parë se detyrimi kushtetues është i pari në këtë rast, prandaj e kemi filluar procedurën, sepse jemi totalisht të bindur se gjendemi përpara shkeljeve të rënda.

A është shkelje e rëndë t'i heqësh qytetarëve të drejtën për zgjedhje periodike, për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre në pushtetin vendor? Përpjekje është, tentativë është nga ana e Presidentit, sepse po ta kishte kryer do të ishte edhe më e rëndë, por fakti që bën tentativa në kundërshtim me kompetencat e tij kushtetuese, është shkelje e rëndë.

Cilat janë kompetencat? Kushtetuta i parashikon qartë. Në nenin 92 ka këto kompetenca, dhe i rendit. Në nenin më poshtë, thotë: “Presidenti i Republikës nuk mund të ushtrojë asnjë kompetencë që nuk i njihet nga neni i mësipërm apo nga ligjet e zakonshme.”

Për të ardhur te provat, Komisioni Hetimor do t'ju sjellë prova të qenësishme, që vetë Presidenti ka deklaruar: “Po, kam shkelur Kodin Zgjedhor, por jo Kushtetutën”.

Mjafton që ka shkelur Kodin Zgjedhor, dhe kjo do të ishte e mjaftueshme, se në referencë të nenit 94, thuhet: “I ndalohet çdo kompetencë, që s'e ka në Kushtetutë e në ligj”.

Për mua është e mjaftueshme që Presidenti të shkarkohet.

Por nuk janë vetëm këto. Janë një tërësi shkeljesh kushtetuese, tashmë të parimit kushtetues, jo politik, të unitetit, sepse është ana politike, por është edhe ana juridike, që Presidenti e ka shkelur.

Të dalë Presidenti i Republikës me letër zyrtare te partnerët tanë, dhe t'u thotë se jemi para një puçi institucional, si mund të konceptohet kjo nga pikëpamja kushtetuese?

Çështje tjetër: si mund ta justifikojmë ne Presidentin e Republikës në këto veprime të çartura? Nëse është i paaftë, atëherë edhe kjo përbën një motiv shkarkimi. Për ata kolegë që nuk e dinë, paaftësia e Presidentit të Republikës... Por ne jemi të bindur se nuk ka ndodhur nga paaftësia,

por nga qëllimi i qartë, dhe qëllimi duket që nga gjeneza e veprimeve e deri në vijimin e veprimeve, deri dhe në këtë shkresë, që një nëpunës i administratës së tij tenton t'i nisë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Prandaj, të nderuar kolegë, le ta bëjmë serioz debatin. Ky nuk është më debat politik, por debat kushtetuese, dhe ne duhet të rrimë brenda kornizave kushtetuese.

E kemi nisur këtë proces. Ftojme të na bashkëngjitet kushdo që mendon si ne, por kushdo që mendon ndryshe është i lirë të japë argumentet e tij, dhe në përfundim të këtij procesi duhet të kuptojë se vendimmarrjen do ta ketë Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Më vonë ka edhe një filtër tjetër, që në kohën e duhur do të tregojë se kemi të drejtë. Deri atëherë, le të mos nxitohe mi, por të gjykojmë me ftohtësi, ashtu siç i ka hije një përfaqësuesi të popullit në Kuvendin e Shqipërisë.

Ju faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni!

Fjalën e ka kërkuar zoti Zeneli. Po, zoti Zeneli.

Alban Zeneli – Faleminderit, zoti kryetar!

Ky komision i nderuar e ka marrë në shqyrtim nismën e 55 deputetëve. Nuk ndjehem mirë për këtë debat apo këtë retorikë politike brenda së majtës, sepse absolutisht që kjo u ka sjellë probleme të mëdha shqiptarëve gjatë këtyre 29 viteve, pavarësisht se parë nga aspekti im personal apo nga aspekti i partisë nga unë vi, ndjehem mirë.

Së bashku me opinionin publik, unë vërej se debati President-qeveri është debati tipik midis të majtës dhe natyrës së të majtës. Ishit ju, mbase jo të gjithë, por ishin disa nga ju socialistët, ata që e zgjodhët Ilir Metën President. Dikur ju e keni zgjedhur edhe Kryeministër, edhe Kryetar Parlamenti, edhe ministër.

Nuk ia dha as Shqipëria e as shqiptarët, mundësinë që ia keni dhënë Ilir Metës ju socialistët. Këto dhurata i ka marrë vetëm nga e majta, domethënë nga ju. Në s'e kemi bërë as Kryeministër, as President...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jua thashë: mua më vjen mirë që e keni debatin mes jush, por ajo për të cilën më vjen keq, është se debati juaj sjell absolutisht probleme për Shqipërinë e për shqiptarët.

Gabimet e së majtës dhe përplasjet e dashuri-urrejtjes historike mes liderëve tuaj, nuk mund të kthehen në kosto kaq të mëdha për shqiptarët. Prandaj, së pari, ju duhet t'u kërkonti të falur shqiptarëve në lidhje me gabimet tuaja historike.

Natyrisht, vota jonë është edhe kundër Presidentit, edhe kundër Kryeministrit, sepse këtë luftë për pushtet, si në rastin kur kanë dashuri, ashtu edhe në rastin kur kanë urrejtje, e kanë përdorur vetëm për të marrë pushtetin e për të plaçkitur shqiptarët.

Faleminderit!

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti Zeneli!

Zoti Alimadhi e ka kërkuar fjalën.

Adriatik Alimadhi – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë jo më kot ju kërkoja shkresën tuaj drejtuar Presidentit. Në fakt, e kisha për procedurë, unë dua t'ju falënderoj për përmbajtjen që keni përcjellë ndaj institucionit të Presidentit, e kam sinqerisht këtë, por e shoh me vend dhe vlerësoj kolegët në lidhje me shkresën e ardhur nga Presidenca, që gjuha e përdorur nuk është gjuhë juridike, ligjore dhe kushtetuese. Këtu thuhet: “Është një proces i rremë”, unë nuk e di se si mund të përdoret një gjuhë e tillë në institucionin e Presidencës. Pra, e shoh me vend debatin që nisi nga kolegët, që kjo nuk është një përmbajtje dhe një shkresë nga një institucion shumë i rëndësishëm. Unë jam shumë dakord me të gjitha faktet ligjore dhe kushtetuese, që ngritën të gjithë kolegët. Unë jam me ju dhe ju mbështes plotësisht, por ajo që dua t'ju them është se përmbajtja ose sjellja politike në këtë rast nuk është në përputhje me interesin kombëtar dhe më duhet të mbaj një qëndrim timin politik, ku votoj kundër kësaj procedure.

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Alimadhi!

Fjalën e ka zoti Gjoni.

Ralf Gjoni- Kam një koment.

Unë jam dakord me parafolësit dhe me kolegët për fyerjen që i bëhet parlamentit dhe këtij komisioni përmes kësaj shkrese të sekretares së Përgjithshme të Presidencës, por dua të ndalem te një problem që ngriti zonja Hysi, e cila u shpreh se nuk ka shans që të shtyhen zgjedhjet, përveç rasteve kur ka marrëveshje politike...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Hysi, ju e dini shumë mirë, madje më mirë se unë, se marrëveshjet politike nuk janë të parashikuara as me Kushtetutë dhe as me ligj për të shtyrë zgjedhjet. Prandaj, u lutem relatorëve

që ta evidentojnë në raportin e tyre faktin që zgjedhjet nuk mund të shtyhen kur janë dekretuar një herë. Me këtë jemi dakord të gjithë dhe nuk ka asnjë dyshim për këtë. Në emër të këtij komisioni, u lutem relatorëve që të përgatisin të gjitha argumentet kushtetuese për të evidentuar shkeljen kushtetuese, duke qëndruar larg çdo interpretimi politik, sepse këtu ka shumë interpretime të tilla, ku ne duhet të jemi të ftohtë nga çdo lloj morali apo çdo lloj emocioni dhe të bazohemi vetëm në ligj e Kushtetutë. Nëse nga ky komision dhe nga votimi në seancë do të vendoset që të ngrihet komisioni hetimor, atëherë do t'i takojë Gjykatës Kushtetuese të re për ta gjykuar këtë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Gjoni!

Person – Zoti Gjoni, ne e dimë që debati prodhon ide dhe mendime. Në kapitullin e Kushtetutës, Peridentitit, të gjithë kemi eksperiencën dhe e dimë të gjithë, i jepet e drejta të dekretojë datën e zgjedhjeve dhe jo ta zhdekretojë datën e zgjedhjeve. Kjo është shumë e qartë.

Ulsi Manja – Zonja Hysi e ka fjalën për procedurë.

Vasilika Hysi – Zoti Gjoni, unë nuk thashë që zgjedhjet shtyhen. Zgjedhjet do të bëhen me 30 qershor dhe detyra jonë, sikurse e kam theksuar, është..., por fakti që Presidenti, në arsyetimet e veta, përmend që ka pasur raste të shtyrjes së zgjedhjeve, thashë që është bërë me ndryshim ligjor.

Ulsi Manja- Faleminderit, zonja Hysi!

Fjalën e ka zonja Bushka. Pastaj fjalën e ka zoti Shameti dhe në fund do të flas unë.

Klotilda Bushka- Faleminderit, zoti kryetar!

I dëgjova me shumë vëmendje të gjithë kolegët. Për efekt të procedurës më duhet që në radhë të parë të fokusohem te çështja e rendit të ditës, kjo edhe për opinionin publik. Ne sot nuk po diskutojmë këtu vlefshmërinë ose jo të dekretit të Presidentit të Republikës, por jemi duke diskutuar, si Komision i Çështjeve Ligjore, kërkesën e 55 deputetëve të parlamentit të Republikës së Shqipërisë sa i takon shkarkimit të Presidentit apo fillimit të një procedure të shkarkimit nga detyra të Presidentit të Republikës si pasojë e një shkeljeje të rëndë kushtetuese, për të gjitha ato arsye që kolegët tanë kanë paraqitur në kërkesën e tyre. Në fakt, e vërteta është që materializimi i shkeljes, që është kryer nga Presidenti, siç kanë vlerësuar 55 kolegët tanë deputetë, është nëpërmjet dekretit, por ne, si Kuvend, në kuadër të nenit 1 të Kushtetutës, ku sovraniteti në Republikën e Shqipërisë ushtrohet nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur prej popullit, të cilët janë në Kuvend, e kemi thënë qartë njëzëri në seancën plenare të fundit, me një rezolutë të votuar dhe të mbështetur nga 100 deputetë, se ky dekret është një akt absolutisht i pavlefshëm dhe është një akt nul i nxjerrë

jashtë tagrit kushtetues që ka Presidenti për të anuluar ditën e zgjedhjeve. Ne kemi rënë dakord politikisht me këtë qëndrim dhe nuk mendoj se tani është momenti të flasim për dekretin, por duhet të flasim për kërkesën e të gjithë deputetëve, të cilët, duke u nisur nga ky akt i Presidentit, për anulimin e datës së zgjedhjeve vendore të 30 qershorit 2019, kanë vlerësuar se kemi të bëjmë me shkelje të rënda të Kushtetutës, që parashikohen qartë në nenin 90, pika 2, të Kushtetutës, i cili i jep të drejtën jo më pak se $\frac{1}{4}$ së anëtarëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë që të kërkojnë fillimin e procedurës së shkarkimit të Presidentit të Republikës në rast se pretendohet se Presidenti ka kryer një shkelje të rëndë kushtetuese ose ka kryer një krim të rëndë. Sot kërkesa e paraqitur nga kolegët është për një shkelje të rëndë kushtetuese. Ne si Komision i Çështjeve Ligjore kemi për detyrë të vlerësojmë nëse kërkesa është paraqitur sipas parashikimeve të Kushtetutës, neni 90 pika 2, dhe sipas procedurës përkatëse, që parashikon Rregullorja e Kuvendit, neni 112, pika 2, i cili parashikon të gjithë hapat proceduralë dhe veprimtarinë parlamentare që ndërmerr Kuvendi kur paraqitet një kërkesë e tillë. Unë, si relatore, çmoj që kërkesa nga pikëpamja formale procedurale është paraqitur në mënyrë të rregullt, pasi nuk është paraqitur nga numri minimal i anëtarëve të Kuvendit që kërkohet të paraqitet kjo kërkesë, por nga një numër shumë i madh, 55 deputetë nga 35 që duhet të ishte minimumi. Kjo është një kërkesë e paraqitur ashtu siç e parashikon Rregullorja e Kuvendit dhe është futur në procedurën parlamentare sipas parashikimit të nenit 112, pika 2, të Rregullores, i cili thotë se Kryetari i Kuvendit, pasi merr kërkesën për fillimin e procedurës së shkarkimit të Presidentit dhe dokumentet shoqëruese të saj, ia përcjell kërkesën Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, i cili brenda 15 ditëve i paraqet Kuvendit raportin dhe propozimin e tij për ngritjen ose mosngritjen e një komisioni hetimor. Në rast se kërkohet nga Presidenti i Republikës për t'u shprehur në Komision, Komisioni është i detyruar ta dëgjojë atë, duke i lënë një kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes dhe dhënien e sqarimeve. Në përputhje me këtë parashikim të Rregullores, me të drejtë, zoti Manja, në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Ligjeve, ka kërkuar që të zbatohet e drejta e Presidentit, nëse do të dëshirojë, të dëgjohej në këtë seancë. Jam dakord me atë që tha zoti Hyseni, që ne nuk kemi një përgjigje të Presidentit të Republikës, por kemi përgjigje të një nëpunësi të institucionit të Presidencës, në një gjuhë joetike, më vjen keq ta them dhe ta konstatoj, të papranueshme për një institucion, në nivelin e rëndësisë, nga më të rëndësishmit në vend dhe nuk mund pranohet një gjuhë therëse, ironike, fyese, përçmuese jo vetëm ndaj deputetëve, në fakt, ndaj atyre që ushtrojnë sovranitetin e popullit, por, siç duket, parimi i sovranitetit të popullit kur

pretendohet që nëpërkëmbet nga Presidenti i Republikës, pse mos ta nëpërkëmbin edhe nëpunësit e tjerë dhe stafi?! Unë gjykoj se këtu është problemi, dhe ky komision duhet ta vlerësojë me shumë seriozitet kërkesën e deputetëve, sepse, përveçse nga pikëpamja formale-procedurale, duhet të gjykojë: a vjen kërkesa në Kuvend për shkarkimin e Presidentit në përputhje me ato që parashikon Kushtetuta, për sa i takon thelbit të asaj që kërkohet? Dhe në thelb të asaj që kërkohet bëhet fjalë për shkelle të rënda. 55 kolegët tanë deputetë, por edhe ata, që votuan rezolutën në lidhje me këtë dekret në seancën e kaluar, kanë vlerësuar se Presidenti ka cenuar rëndë parimin e ushtrimit të sovranitetit nga populli; Presidenti me dekret ka zgjatur mandatin e organeve të qeverisjes vendore tej mandatit të tyre 4-vjeçar, që parashikon Kushtetuta, kanë vlerësuar që kompetenca e Presidentit, në lidhje me zgjedhjet, është vetëm të caktojë datën e zgjedhjeve e dhënë kjo në Kushtetutë dhe në Kod Zgjedhor, dhe jo ta ndryshojë, ta shfuqizojë apo ta anulojë këtë datë. Duke anuluar datën me dekret, Presidenti ka tejkalluar kompetencat e tij, dhe jo vetëm, por kolegët tanë deputetë, kërkuesit kanë qartësuar në kërkesën e tyre faktin që anulimi i datës së zgjedhjeve vjen kur procesi zgjedhor është realizuar në 85% të tij, sot jemi në 90% të tij, pra duke vlerësuar se duhen marrë në konsideratë pasojat që sjell akti për anulimin e datës së zgjedhjeve vendore, sepse nuk janë pasoja të lehta, qoftë për të drejtat e shtetasve për të votuar, qoftë për subjektet zgjedhore, qoftë ato ekonomike, të cilat vijnë si rrjedhojë e realizimit të një procesi, i cili ka nisur, për hir të së vërtetës, që në nëntor të vitit 2018, kur Presidenti nxori të vetmin akt të ligjshëm në lidhje me zgjedhjet vendore të vitit 2019; dekretin që caktoi, se zgjedhjet do të bëhen më 30 qershor 2019.

Gjithashtu, kolegët tanë, që kanë paraqitur kërkesën për shkarkim, pretendojnë, vlerësojnë dhe arsyetojnë në kërkesën e tyre se akti i Presidentit ka cenuar mundësinë e zgjedhësve për të zgjedhur, mundësinë për të pasur një qeverisje lokale nëpërmjet zgjedhjeve dhe nëpërmjet vullnetit të popullit.

Gjithashtu, kolegët tanë janë ndalur edhe në pasojat që ka sjellë akti. Për sa u përket pasojave, kolegët arsyetojnë se Presidenti, duke marrë tagrat të sovranit dhe të Kuvendit ka ushtruar një pushtet të pakufizuar ekzekutiv, përkundër natyrës që ka Presidenti në një republikë parlamentare, duke anuluar arbitrarisht datën e zgjedhjeve, pasi nuk dua t'i përsëris tashmë argumentet që thanë kolegët. Zonja Hysi e përmendi shumë qartë faktin e traditës parlamentare në rastet e mëparshme të viteve 2007 dhe 2017, por nuk jemi fare në situata të tilla të ngjashme. Prandaj themi se arbitrarisht është anuluar data e zgjedhjeve, është cenuar parimi i periodicitetit të zgjedhjeve; është cenuar parimi i ushtrimit të pushtetit në shtet nga një qeverisje që del nga

zgjedhje të lira (pra po citoj të gjitha argumentet e kërkesës për shkarkim, ato që kanë të bëjnë me thelbin, me shkeljen kushtetuese); është cenuar parimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë dhe është nxjerrë akt në kundërshtim të hapur flagrant, me Kushtetutën dhe me ligjet, duke sjellë si pasojë cenimin e parimit të drejtës së qytetarëve si sovranë për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur. Në thelb, këto shkelje pa diskutim që meritojnë një hetim nga një komision hetimor, sepse janë shkelje, të cilat, ashtu siç analizohen dhe vlerësohen në kërkesën e paraqitur nga kolegët tanë, shumë të rënda të Kushtetutës. Mendoj se të gjithë biem dakord që dekreti i Presidentit për anulimin e datës së zgjedhjeve ishte një shkelje e rëndë e Kushtetutës, por duhet analizuar në pikëpamjen e shkeljes që ka të bëjë me shkarkimin e Presidentit, sipas procedurave që parashikon Rregullorja e Kuvendit.

Kam një përgjigje për zotin Zeneli. Zoti Zeneli, unë nuk mendoj se është argument fakti që kjo është një retorik brenda së majtës. Mendoj se si për të majtën, si për të djathtën, si për çdo kah politik, kushdo qoftë President, kushdo qoftë titullar i shtetit, në qoftë se ka bërë një shkelje të rëndë kushtetuese, të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe këtu nuk bëhet fjalë për të vlerësuar thjesht një kërkesë dhe për të bërë një procedurë. Ne këtu kemi detyrë për të qenë të përgjegjshëm që kur bëhet fjalë për cenim të rendit kushtetues, kërkesën e drejtë të ligjshme të 55 kolegëve deputetëve, që legjitimohen ta ngrenë këtë kërkesë ta marrim në shqyrtim dhe ta vlerësojmë me seriozitet dhe me përgjegjshmëri.

Dua të ndalem në lidhje me thelbin vetëm te 2 çështje. Thamë se kemi të bëjmë, në kuptimin formal procedural, me një kërkesë që bazohet në Kushtetutë dhe në Rregulloren e Kuvendit, të kolegëve tanë deputetët për fillimin procedurës për shkarkimin e Presidentit. Kemi vlerësime në kërkesën e paraqitur për shkelje kushtetuese, të cilat, në thelb, janë të tilla që duhet t'i nënshtrohen një hetimi nga komisioni hetimor, por patjetër duhet të konstatojmë këtu që, në qoftë se argumentet e paraqitura në shkresën që ka ardhur si përgjigje dhe që është firmosur nga një përfaqësues i stafit të Presidencës, që ky dekret është nxjerrë për të ndaluar ndasitë në vend, në kuadrin e atij që Presidenti e quan, parim të përfaqësimit të unitetit kombëtar.

Po të nisemi nga ajo që thotë zonja Mara, të shikojmë pak pasojat, ky dekret jo vetëm që këto ndasi (ato që kupton institucioni i Presidentit janë, se nuk i kemi të qarta se cilat janë këto ndasi), jo vetëm që nuk kanë ndryshuar, por pas dekretit të Presidentit, atij, që, në fakt, ka anuluar padrejtësisht datën e zgjedhjeve të 30 qershorit, janë thelluar edhe më shumë. Nëse shikojmë në të gjithë Shqipërinë në qytetet të ndryshme janë kryer veprime tej normave ligjore nga opozita

jashtëparlamentare, të cilat kanë synuar destabilizimin e rendit juridik; veprime të dënueshme nga ligji, të cilat në artikulumet e liderëve politikë jashtëparlamentarë bazohen dhe kanë për sebeb këtë dekret; atë për anulimin e datës së zgjedhjeve. Pra, ai që, në fakt, duhet të jetë figura e unitetit kombëtar ka kontribuar për të kundërtën e saj, duke mbajtur kahe politike, duke thelluar ndasitë politike. Pa diskutim, që kjo meriton një hetim, si një shkelje e rëndë kushtetuese. Mendoj se ky duhet të jetë mbizotërimi i hetimit në komisionin hetimor, nëse do të vendosim ta ngremë, që mendoj se tashmë e kemi lëndën.

Së dyti, ka të bëjë me faktin që askush, qoftë edhe Presidenti i Republikës së Shqipërisë, nuk mund të ndërhyjë në të drejtën e qytetarëve për të zgjedhur. Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor thonë: “Caktohet data e zgjedhjeve nga Presidenti dhe Presidenti mbaron detyrën e tij me zgjedhjet”. Nuk mundet të ndërhyhet në fund të procesit dhe t’u thuhet qytetarëve, nuk keni për të votuar, sepse janë 1, 2, 3, apo 7 arsye dhe asnjëra nga ato arsye, nuk përlligjet në një nen të vetëm, e zeza mbi të bardhë, që i jep kompetencë Presidentit për këtë vendimmarrjeje. Më falni që u zgjata, por në kuadrin e relatores më duhet të shpjegoja edhe për opinionin publik procedurën dhe gjithçka që ne jemi duke bërë këtu. Besoj se do të jemi në një mendje edhe me relatorin tjetër me zotin Shameti që duke vlerësuar se kërkesa e paraqitur nga 55 kolegët tanë deputetë, nga aspekti formal-procedural është një kërkesë e paraqitur në përputhje me ligjin, që i plotëson të gjitha kriteret ligjore dhe në thelb parashikon, sipas nenit 90/2 të Kushtetutës hetimin e shkeljes së rëndë, unë do të sugjeroja që ne të jemi pro procedurës së shkarkimit nëpërmjet ngritjes së një komisioni hetimor.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Bushka!

Ju lutem, zoti Zeneli, por...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, fjalën e ka zoti Zeneli dhe pastaj zoti Shameti.

Alban Zeneli – Faleminderit, zoti kryetar!

Zonja Bushka, më duket se nuk e kuptuat siç duhet thelbin e asaj çfarë thashë unë. Me pak fjalë unë thashë që ju duhet të mbani një lloj përgjegjësie morale, si maxhorancë, sepse shpeshherë e keni vlerësuar Presidentin Meta në disa...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si drejtues të një prej institucioneve më të rëndësishme të vendit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Duke pasur edhe përvojën e Presidentit Meta, absolutisht unë dhe kolegët e mi do të jemi të gatshëm që të ngrihet një komision hetimor për të parë me të vërtetë nëse Presidenti e ka shkelur ose jo Kushtetutën dhe ku, pra do të marrim të gjitha argumentet politike, ligjore dhe juridike. Por në fund është Gjykata Kushtetuese ajo që vendos nëse Presidenti e ka shkelur ose jo atë.

Pyetja ime ishte: a keni ju përgjegjësi morale për këtë vlerësim kaq të madh që i keni bërë këtij Presidenti, në raport me qytetarët shqiptarë?

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Zeneli!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Përgjegjësinë morale e ndajnë qytetarët me votë kur shkojmë çdo katër vjet në zgjedhje. Kështu që, gjithsesi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, zoti Zeneli!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Shameti, fjala është për ju si relator, pastaj...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, e mbyllim!

Adnor Shameti – Faleminderit!

(Diskutime në sallë)

Zonja Bushka, ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Fjala e parlamentit është të enjten.

Zoti Shameti, fjala është për ju.

Adnor Shameti – Faleminderit, zoti kryetar!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zyshë, ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Po kur flet ti?

(Ilaritet në sallë)

Adnor Shameti – Po, po.

(Deputeti Gjoni ndërhyr pa mikrofon.)

Ulsi Manja – Është hera e parë që ky Kuvend dhe ndoshta nuk di a do ta ketë më shansin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, zoti Gjoni!

Nuk e di nëse do të ketë më rast tjetër ku Kuvendi i Shqipërisë do të përfshihet me procesin e shkarkimit të një Presidenti Republike!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Shameti.

Adnor Shameti – Faleminderit, zoti kryetar!

Në cilësinë e relatorit për një çështje kaq të rëndësishme, dua të bëj edhe përmbledhjen e argumentit ligjor dhe procedural të paraqitur para këtij komisioni. Dua ta nis aty ku e përfundoi zoti Zeneli dhe dua ta vlerësoj shumë atë kur tha: “Ne jemi shumë dakord që në këtë komision të votojmë për t’i propozuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë ngritjen e një komisioni hetimor”. E vlerësoj shumë këtë.

E nisa nga zoti Zeneli, por dua të vlerësoj të gjithë kolegët, si ata të opozitës, ashtu edhe ata të maxhorancës, për diskutimet produktive dhe argumentet ligjore e politike që sollën para këtij komisioni të nderuar. Në veçanti dua të falënderoj zonjën Bushka, bashkëkolege dhe relatore në këtë çështje që po diskutohet, pasi ajo me një argument shterues ka paraqitur të gjitha elementet procedurale, që janë ndjekur me përpikëri nga grupi nismëtar i deputetëve, si dhe të gjitha elementet e tjera, që zonja Bushka i elaboroi në veçanti me përpikëri të lartë.

Duke qenë se duhet të përmbylim të gjithë argumentin për gjetjet ligjore të asaj kërkesë të paraqitur para këtij komisioni të nderuar nga një grup kolegësh prej 55 deputetësh, më lejoni të bëj një përmbledhje shkurtimisht të argumenteve ligjore që grupi i kolegëve dhe ne si relatorë kemi gjetur në paraqitjen e këtij argumenti, për të bërë të mundur përmbylljen e këtij procesi dhe rekomandimet përkatëse Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Këto argumente ligjore në lidhje me shkeljen e rëndë të Kushtetutës, të bërë nga Presidenti i Republikës nëpërmjet dekretit, i cili zhdekreton datën 30 qershor si datë e zgjedhjeve për pushtetin lokal, është shkelje për arsyet e mëposhtme.

Së pari, Presidenti nuk ka kompetencë për të nxjerrë këtë akt.

Referuar parashikimeve kushtetuese në lidhje me zgjedhjet, Presidenti ka vetëm një kompetencë, atë të dekretimit të datës së zgjedhjeve, prej të cilit ndërvaren një sërë vendimmarrjesh të KQZ-së. Kjo e fundit, sapo merr dijani për dekretin e datës së zgjedhjeve, fillon veprimtarinë për organizimin dhe menaxhimin e procesit zgjedhor. Kjo kompetencë ushtrohet nga Presidenti vetëm një herë për çdo zgjedhje.

(Diskutime në sallë)

Zoti Fino, a ka mundësi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem!

Adnor Shameti – Sipas parashikimeve kushtetuese dhe të legjislacionit në fuqi për zgjedhjet, që ka të bëjë me nenet 92/gj dhe 94 të Kushtetutës, si dhe nenet 8, 9 dhe 10 të Kodit Zgjedhor, ndryshimi i datës së zgjedhjeve administrative nuk është një prerogativë e Presidentit e parashikuar në Kushtetutë ose në Kodin Zgjedhor.

Sipas nenit 94 të Kushtetutës, Presidenti i Republikës nuk mund të ushtrojë kompetenca të tjera përveç atyre të njohura shprehimisht në Kushtetutë dhe në ligj. Akti që del në mungesë të kompetencës është nul dhe konsiderohet që nuk ka ekzistuar ndonjëherë.

Dua të sqaroj edhe diçka tjetër: nenet 92/gj, 93 dhe 94 të Kushtetutës konsiderojnë dekrete vetëm ato elemente, zoti Fino, që parashikohen në këto dispozita. Në çdo rast tjetër, kur Presidenti disponon me një akt, nuk kemi të bëjmë me dekret.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kam parasysh këtu edhe njoftimin e ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i cili vjen në të njëjtën linjë me këtë që sapo thashë, që, po ta keni ndjekur me vëmendje (e keni edhe në faqen *online* të ambasadës), flitet për *announcement*, jo për dekret. *Announcement* është njoftim, që, me të drejtë, zoti Gjoni e përkthen *mot à mot*. Prandaj mbetet i tillë dhe nuk ka lidhje me të.

Shkeljet e rënda kushtetuese që konstatohen janë: cenon rëndë të drejtën e zgjedhjes së shtetasve, që është neni 45 i Kushtetutës; ka shkelur parimin e unitetit kombëtar, që është neni 86; ka shkelur parimin e periodicitetit të zgjedhjeve, që është neni 1, paragrafi i tretë i Kushtetutës, ku thuhet: “Në Shqipëri qeverisja bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike”... Periodiciteti është katër vjet. Shtyrja e zgjedhjeve, për më tepër edhe pa datë, e cenon periodicitetin, pasi lë në detyrë organet e zgjedhura më shumë se katër vjet.

Gjithashtu, shkelet parimi i sovranitetit të popullit, që është neni 2, paragrafët 1 dhe 2, i Kushtetutës. E drejta e sovranitetit të popullit është e drejtë që ai e ushtron nëpërmjet përfaqësuesve, të zgjedhurve deputetë në Kuvend, të zgjedhurve në pushtetin lokal ose direkt, që është rasti i referendumeve. Këtë të drejtë populli do ta ushtrojë më 30 qershor. Me shtyrjen e datës nga Presidenti, kjo e drejtë mohohet.

Presidenti u zgjati organeve vendore mandatin tej afatit kushtetues, që është neni 109 i Kushtetutës, pasi mosrealizimi i zgjedhjeve vendore në kohë, ashtu siç Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor e parashikojnë, na sjell në këtë pikë.

Presidenti shkeli rëndë traditën kushtetuese të konsultimit të palëve. Nuk mund të ketë ndryshim të datës së zgjedhjeve pa pëlqimin paraprak të partive politike, që janë palë në procesin zgjedhor, aq më tepër kur procesi është gati në përfundim të tij. Në rastin e ndryshimit të datës së zgjedhjeve në vitin 2007 dhe 2017 ishte një situatë krejt tjetër, sepse palët u dakordësuan për shtyrjen e datës së zgjedhjeve. Në këto raste Presidenti, me konsensusin e tyre, vendosi të shtyjë datën në një datë tjetër, por pa cenuar ligjin dhe mandatin e organeve të zgjedhura. Shtyrja e datës u bë brenda kufijve të ligjit, pa cenuar atë që konsiderohet periudhë zgjedhore.

Në rastin konkret çështja është krejt ndryshe, sepse data zgjedhore shkon pas datës 15 shtator 2019. Dekreti që Presidentit tentoi të shfuqizojë i është nënshtruar me rigorozitet kësaj procedure kushtetuese që parashtrova më sipër. Presidenti tenton të justifikojë aktin e tij me arsyetimin e sigurisë kombëtare, në një kohë që nuk e ka përgjegjësi direkte këtë çështje. Është e qartë që, në bazë të legjislacionit tonë, siguria kombëtare është kompetencë e pastër e pushtetit ekzekutiv dhe aspak përgjegjësi direkte e Presidentit.

Në një republikë parlamentare si kjo jona Presidenti është organ neutral, i paanshëm dhe i pavarur, që qëndron në të gjitha pushtetet dhe nuk bën pjesë në asnjërin prej tyre, është institucion që nuk mund të jetë aktiv në proceset vendimmarrëse politike dhe ka kompetenca formale dhe jo thelbësore dhe vendimmarrëse.

Argumentet që solli Presidenti janë hartim i neneve kushtetuese që nuk legjitimojnë aktin e tij. Gjithçka që Presidenti deklaroi në datën 10 qershor dhe argumentet që jep për të bazuar qëndrimin e tij për aktin që anulon zgjedhjet, janë thjesht citime të parashikimeve ligjore kushtetuese dhe parime të përgjithshme të një shoqërie demokratike, të cilat, nëse vendosen jashtë çdo konteksti real, kthehen në deklaratatë të një shkeljeje të rëndë të Kushtetutës.

Presidenti me këtë veprim krijoi një precedent të rrezikshëm për republikën tonë parlamentare, ku Presidenti më së shumti ka rol protokollar. Sipas logjikës së Presidentit, ai mund të anulojë apo shfuqizojë çdo dekret për emërime, shkarkime, e të tjera, por kjo do të cenonte rëndë veprimtarinë shtetërore të tre pushteteve të shtetit, ku, siç thamë më sipër, Presidenti merr pjesë, por nuk bën pjesë.

Dekreti i Presidentit për caktimin e datës 30 qershor për mbajtjen e zgjedhjeve vendore është i vetmi akt i ligjshëm i nxjerr nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë në kuadër të zgjedhjeve vendore të vitit 2019.

Akti i Presidentit për shfuqizimin e dekretit të mësipërm është i pavlefshëm dhe si i tillë konsiderohet nul dhe nuk mund të prodhojë asnjë pasojë.

Në cilësinë e relatorit të kësaj çështjeje kaq të rëndësishme që shqyrtuam sot në Komisionin e Ligjeve, dua të informoj kryetarin e komisionit dhe këtë komision të nderuar që në relacionin përfundimtar, që unë dhe zonja Bushka do të përpilojmë, do të gjejnë pasqyrim të gjitha gjetjet e rëndësishme që kolegët e nderuar të këtij komisioni paraqitën. Ju siguroj që në një afat sa më të afërt do të sjellim para jush raportin përfundimtar, i cili i sugjeron Kuvendit të Republikës së Shqipërisë ngritjen e komisionit hetimor për hetimin e Presidentit të Republikës dhe hapjen e procedurës për shkarkimin e tij.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Shameti!

Nuk besoj se ka diskutime të tjera.

Si kryetar i komisionit, përveç drejtimit të këtij komisioni të nderuar, kam edhe unë të drejtën të flas dhe jap mendimet e mia për kërkesën e 55 kolegëve deputetë, të cilët kërkojnë shkarkimin e Presidentit të Republikës për shkelje të rëndë të Kushtetutës, konkretisht të nenit 90/2 të Kushtetutës.

Si fillim dua t'ju falenderoj për natyrën dhe nivelin e debatit! Është një debat sa politik, aq edhe kushtetues dhe juridik.

Më lejoni, të nderuar kolegë, të sjell në vëmendjen tuaj dhe të opinionit publik se i gjithë diskutimi ynë për këtë kërkesë fillon dhe mbaron te neni 1 i Kushtetutës: “Shqipëria është republikë parlamentare”.

Kërkesa e kolegëve, por edhe debati dhe diskutimi, që bëhet sot në Komisionin e Ligjeve dhe në Kuvendin e Shqipërisë, është për të mbrojtur Republikën.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e ka paraparë procesin e shkarkimit të Presidentit të Republikës të ndarë ndërmjet Kuvendit dhe Gjykatës Kushtetuese, për t'i dhënë rolin e duhur kushtetues që ka Presidenti, si garant i unitetit të popullit dhe mbi palët.

Pse mes Kuvendit dhe Gjykatës Kushtetuese? Sepse është Kuvendi ai që e zgjedh presidentin dhe në një republikë parlamentare presidenti është organ kushtetues përfaqësues. Bartës i sovranitetit të popullit dhe i votës së qytetarëve shqiptarë është Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Çfarë bën Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në rast se ka një kërkesë për shkarkimin e Presidentit të Republikës, siç është rasti konkret që po diskutojmë sot? Nëpërmjet Komisionit të Ligjeve, në këtë fazë të shqyrtimit të kërkesës, Kuvendi zgjidh tri gjëra.

A është e formalizuar kërkesa, sipas nenit 112, pika 1 e Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë? A është nënshkruar nga 1/4-ta e deputetëve? Po, 55 kolegë deputetë të Kuvendit të Shqipërisë kanë nënshkruar një kërkesë për shkarkimin e Presidentit të Republikës.

A ka objekt kërkesa? A është i ligjshëm ky objekt i kërkesës? Po, sigurisht. Kolegët deputetë, nënshkruar të kësaj kërkesë, kanë kërkuar në objekt shkarkimin e Presidentit të Republikës, duke vendosur si bazë kushtetuese nenin 90, pika 2 e Kushtetutës. Pra, kolegët pretendojnë që Presidenti i Republikës, me dekretin për çdekretimin e datës së zgjedhjeve, të 30 qershorit, ka shkelur rëndë nenin 90/2 të Kushtetutës.

Në lidhje me përmbajtjen e kërkesës, a mjaftohet ky komision në arsyetimin nëse ekziston apo jo ky fakt kushtetues? Pra, a e ka anuluar Presidenti i Republikës nëpërmjet një dekreti datën e zgjedhjeve të 30 qershorit? Po, sigurisht. Ky është një fakt i bërë publik.

Pjesa tjetër e veprimtarisë parlamentare, për ta çuar deri në fund kërkesën e kolegëve për shkarkimin e Presidentit të Republikës, materializohet nëpërmjet një komisioni hetimor parlamentar, i cili do të konstatojë shkeljen e nenit 90/2 të Kushtetutës nga Presidenti, natyrisht, duke grumbulluar faktet dhe provat që çojnë në favor të kërkesës së 55 kolegëve deputetë. Natyrisht, për shkarkimin e Presidentit të Republikës në fund do të ketë një votim me shumicë kushtetuese në seancë.

Sigurisht, vendimmarrja e Kuvendit është e natyrës politike, sepse, në fund të fundit, do të votojnë deputetët. Prandaj, si garanci kushtetuese e një procedure jo të zakonshme të shkarkimit të Presidentit të Republikës, po kjo Kushtetutë, ka paraparë Gjykatën Kushtetuese si rojtare të Kushtetutës. Do të jetë Gjykata Kushtetuese ajo që do të konstatojë nëse shkelja e rëndë e

Presidentit të Republikës është kryer me faj ose jo dhe në fund do të vendosë shkarkimin e Presidentit të Republikës. Kjo nuk do të thotë se Kuvendi i Shqipërisë, në një republikë parlamentare si jona, mund të kufizohet me inicimin e një procedure shkarkimi të Presidentit të Republikës.

Tani, vijmë te rasti konkret. Unë e nisa me nenin 1 të Kushtetutës, por duke e lexuar në frymë dhe në germë Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, më lejoni të sjell në vëmendjen tuaj se Kushtetuta jonë i ka paraparë në mënyrë shteruese kompetencat e Presidentit të Republikës në nenin 92 të saj. Kushtetuta thotë qartë se Presidenti i Republikës nuk mund të ushtrojë asnjë kompetencë tjetër përveç atyre që janë përcaktuar në nenin 92 dhe me ligj të veçantë. Meqenëse dekreti ka të bëjë me procesin zgjedhor, po i referohem Kodit Zgjedhor.

Kompetenca e Presidentit, e materializuar në nenin 92, germa “gj” e Kushtetutës për përcaktimin e datës së zgjedhjeve është kompetencë kushtetuese, substanciale dhe shteron në momentin që Presidenti e ushtron nëpërmjet një akti individual. Pas caktimit të datës së zgjedhjeve, 30 qershor 2019, shteron kompetenca e presidentit, sepse të gjitha detyrimet kushtetuese dhe ligjore u kalojnë organeve të tjera publike, që merren me miradministrimin e procesit zgjedhor, si, KQZ-ja, Ministria e Brendshme, bashkitë, prefekturat dhe zyrat e gjendjes civile.

Presidenti i Republikës ka ushtruar në mënyrë të njëanshme, edhe një të drejtë që ai mendon se e ka me Kushtetutë. Pasi filloi procesi zgjedhor, nxori një dekret tjetër për çdekretimin e datës së zgjedhjeve. Në fakt, jo vetëm që Kushtetuta nuk ia jep, por Presidenti ka lejuar të bëjë një interpretim të zgjeruar të kompetencave kushtetuese, që në gjuhën e Kushtetutës quhet, as më shumë e as më pak, akaparimi i kompetencës kushtetuese. Të marrësh diçka që nuk ta jep Kushtetuta, konsiderohet tejkalim kompetence dhe shkelje kushtetuese.

Dikush mund të thotë, ose qytetarët mund të pyesin: çfarë ka shkelur Presidenti i Republikës? Kolegët e mi në diskutimet e tyre, por edhe relatorët, si zoti Shameti dhe zonja Bushka, argumentuan në mënyrë kushtetuese dhe juridike se pse kemi të bëjmë më shkelje të nenit 92 të Kushtetutës, aq e më tepër që ky diskutim vjen në kohën kur Kuvendi si mbartës i sovranit ka miratuar një rezolutë, që e konsideron nul aktin e Presidentit për çdekretimin e datës së zgjedhjeve. Personalisht mendoj se në morinë e të gjitha argumenteve që jepen, Presidenti ka shkelur nenin 45/1 të Kushtetutës, që është e drejta e qytetarëve shqiptarë për t’u zgjedhur dhe për të zgjedhur, madje kjo është pika kryesore e diskutimit në raport me aktin e Presidentit për zhdekretimin e datës së zgjedhjeve. Presidenti i Republikës, duke folur në cilësinë e garantit të

unitetit të popullit thotë – “E ndërmora këtë akt për të garantuar të drejtën e qytetarëve shqiptarë për të votuar”. – asaj pjese që kanë vendosur të mos marrin pjesë në zgjedhje. Por, në fakt, Presidenti, duke u kujdesur të garantojë të drejtën e votës për qytetarët që nuk do të marrin pjesë në zgjedhje, ia ka mohuar palës tjetër që duan të shkojnë të votojnë dhe nuk ka bërë as njërën e as tjetrën, pra i është shmangur detyrimit kushtetues për t’u garantuar qytetarëve shqiptarë ushtrimin e të drejtës së votës. Në një republikë parlamentare vendosin partitë për popullin apo populli për partitë? Sigurisht që vendos populli për partitë. Presidenti ka shkelur parimin themelor kushtetues të neutralitetit dhe të qëndrimit mbi palët politike. Në vlerësimin tim, Presidenti ka shkelur edhe nenin 1/3 të Kushtetutës, parimin e periodicitetit të zgjedhjeve. Në Kushtetutë thuhet: “Kryetarët e bashkive dhe këshillat, si organe përfaqësuese, zgjidhen çdo 4 vjet”. Presidenti i Republikës, duke akaparuar një kompetencë që nuk ia jep Kushtetuta, siç është çdekretimi i datës së zgjedhjeve, u ka zgjatur mandatin të zgjedhurve vendorë në mënyrë të kundërligjshme. Kjo është e lidhur ngushtësisht me të drejtën e ushtrimit të votës nga ana e qytetarëve shqiptarë.

Unë nuk do të zgjatem më tepër në argumentet e kërkesës së 55 kolegëve deputetë për shkarkimin e Presidentit të Republikës, sepse një pjesë e tyre u thanë. Komisioni hetimor parlamentar, që relatorët sugjerojnë për seancën, të cilit i bashkëngjitem edhe unë, jam i bindur që do ta bëjë këtë në mënyrë shteruese.

U sugjeroj relatorëve që pjesë e raportit të Kuvendin, ku do të kërkohet ngritja e komisionit hetimor parlamentar, të jetë edhe hetimi i përgjigjes që Presidenti i Republikës i ka sjellë Komisionit të Ligjeve, i cili, në respekt të plotë të nenit 112/2 të Rregullores së Kuvendit, as më shumë dhe as më pak, me një gjuhë të qartë kushtetuese, juridike dhe ligjore është kujdesur t’i garantojë Presidentit të Republikës të drejtën për t’u dëgjuar para se Kuvendi i Republikës së Shqipërisë të operojë me ngritjen e një komisioni hetimor parlamentar. Gjuhën e përdorur e konsideroj tërësisht ironike, hipokrite, por edhe fyese për institucionin nga ku ka lindur Presidenti i Republikës. Fyerja ndaj atij që të ka dhënë votën për të shkuar në atë karrige, është një arsye dhe një argument më tepër që Komisioni Hetimor Parlamentar të involvohet edhe në hetimin e kësaj korrespondence me Kuvendin, si pjesë e veprimtarisë së Presidentit, në shkelje të nenit 90/2 të Kushtetutës. Një nëpunëse civile e administratës së Presidentit të Republikës është shumë e vogël për të gjykuar këtë komision të nderuar, po ashtu edhe parlamentin e Shqipërisë si vartësin e sovranitetit të popullit.

Të nderuar kolegë, më sugjerimin për relatorët, dua ta mbyll mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, zoti Gjoni!

Relatorët, doni kohë për raportin?

(Diskutime pa mikrofon.)

Ju lutem, zoti Gjoni! Pas fjalës së kryetarit nuk flitet.

Një fjali për procedurë.

Ralf Gjoni – Faleminderit!

Unë jam dakord me ju që letra nga sekretarja e Përgjithshme e Presidencës ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Një minutë, të flas!

Nuk i takon korrespondencës së Presidentit.

Sugjeroj t'i rikërkojmë Presidentit të paraqitet në komision.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Një minutë, ju lutem!

Sugjeroj që para se të ngremë komisionin hetimor, t'i rikërkojmë Presidentit të paraqitet në këtë komision, meqenëse është e parashikuar në Kushtetutë dhe në Rregullore, duke marrë në konsideratë edhe situatën e nxehtë politike një javë përpara zgjedhjeve lokale.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Gjoni!

Presidenti i Republikës ka edhe një stacion tjetër ku mund të ushtrojë të drejtën për t'u dëgjuar, në komisionin hetimor që do të ngrejë parlamenti. Mosparaqitja sot në Komisionin e Ligjeve nuk e pengon punën e komisionit për të operuar me shqyrtimin e kërkesës.

Relatorët kërkojnë kohë sipas kalendarit që kemi miratuar. Ditën e mërkurë do të kemi raportin e relatorëve dhe më pas votimin në komision për seancën plenare. Ditën e mërkurë do të jetë votimi i raportit.

Faleminderit, të nderuar kolegë!

Faleminderit, medieve dhe të ftuarve!

Ditën e mirë dhe javë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA